

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E
MBAJTUR MË 11 SHTATOR 2003**

**PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 11. 09. 2003. GOD.**

**Shtator – Septembar
2003**



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Paraqitja para deputetëve e z. Harri Holkery, përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe z. Kris Patten, komisioner i BE për politikë të jashtme.
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prokurimin publik në Kosovë (2003/13),
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pension të aftësisë së kufizuar (2003/23),
5. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për çështje gjyqësore, legislative dhe Kornizë Kushtetuese, për emërimin e gjyqëtarëve, në bazë të të dhënave shtesë,
6. Shqyrtimi i propozimit të Grupit parlamentar të LDK-së për emërimin e disa anëtarëve në komisionet parlamentare,
7. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare me 18 shtator 2003:
 - 7.1 Shqyrtimi i situatës politike në Kosovë,
 - 7.2 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet dhe paisjet medicinale (2003/17),
 - 7.3 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për inspektoratin sanitar (2003/24).



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

ДНЕВНИ РЕД

1. Обрачање г.Хари Холкерија, специјалног представника генералног секретара и г.Крис Паттен, комесар ЕУ за спољну политику.
2. Усвајање записника са претходне седнице,
3. Друго разматрање Нацрта закона о јавној набавци на Косову (2003/13),
4. Прво разматрање Нацрта закона о пензији ограничене способности (2003/23),
5. Разматрање Препоруке Комисије за правосудна питања, законодавства и Уставни Оквир, о именовану судија на основу допунских података,
6. Разматрање предлога Скупштинске групе ДСК о именовану појединих чланова Скупштинских комисија,
7. Предлог дневног реда за пленарну седницу од 18 септембра 2003 године :
 - 7.1 Разматрање политичке ситуације на Косову,
 - 7.2 Прво разматрање Нацрта закона о медицинским производима и медицинску опрему (2003/17),
 - 7.3 Прво разматрање Нацрта закона о санитарној инспекцији (2003/24).



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

AGENDA

1. Presentation of Mr. Harri Holkery, Special Representative of the General Secretary and Mr. Kris Patten, Commissioner of EU on Foreign Politics, to the deputies of the Assembly
2. Approval of the minutes of previous meeting,
3. Second reading of the Draft Law on Public Procurement in Kosovo (2003/13),
4. First reading of the Draft Law on pension for limited abilities (2003/23),
5. Review of the Recommendations by the Comity of Judicial matters, Legislative and Constitutional Framework on the nomination of Judges, based on the additional data information,
6. Review on the proposal of the Parliamentary Group of LDK on the nomination some members in the Parliamentary Committees
7. Proposal of the agenda for plenary session on 18 September 2003 :
 - 7.1 Review of the Political Situation in Kosovo
 - 7.2 First reading of the Draft Law on Medical Products and Medical Equipments (2003/17),
 - 7.3 First reading of the Draft Law on Sanitary Inspectorate (2003/24).

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 11 SHTATOR 2003

KRYESUES I SEANCËS, AKADEMIK NEXHAT DACI, KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.

BASHKËKRYESUES OLIVER IVANOVIQ, ANËTAR I KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS.

Seanca u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal - Prishtinë.

Seanca filloi punën në orën 11,30.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes kolegë deputetë dhe mysafirë.

Mirëseerdhët në Seancën e rregullt plenare të Kuvendit të Kosovës, president zoti Rugova, PSSP zoti Hollkeri, kryeministër zoti Rexhepi, komisionar i lartë zoti Kris Paten, ministër dhe në veçanti zonjë Marsi Ris, përfaqësuese e Shteteve të Bashkuara.

Sot, Parlamenti i Kosovës, si dhe e gjithë Kosova, është me popullin Amerikan, prandaj rrespekti im i veçantë për pjesëmarrje në punë të Parlamentit tonë.

Kolegë të nderuar, më lejoni që, shumë shkurt, për shkak të kohës, t'i njoftoj mysafirët e rrespektuar, zotin Paten dhe zotin Hollkeri për sfidat që përcjellin punën në Parlamentin e Kosovës, për përcaktimin e plotë të njëmendët të Kuvendit të Kosovës dhe të popullit të Kosovës për zhvillimet demokratike në Kosovë, për kontributin paqës në Kosovë dhe në rajon, të shpreh kënaqësinë e Kuvendit të Kosovës për të arriturat e përbashkëta në çlirimin e Kosovës, në rindërtimin e saj dhe në hapat e parë në zhvillimin e proceseve demokratike në Kosovë, për një rrugë të suksesshme të përbashkët, edhe pse jo të një dinamike që do të kënaqte popullin e Kosovës dhe bashkësinë ndërkombëtare, ndërsa të përfundojë sfidat kryesore me të cilat ndeshet Parlamenti i Kosovës

janë të dylojshme: janë të natyrës ekonomike që, edhe katër vite pas luftës, nuk po arrijmë ta sfundojmë Kosovën dhe ekonominë e saj të tregut me ligjet bazë që do të mundësonin riaktivizimin e resurseve të bollshme të Kosovës dhe këtë për arsye të mungesës së kompetencave të mjaftueshme të Qeverisë së Kosovës që të bëjë seleksionimin për sponsorizim të ligjeve që i duhen Kosovës dhe, sfida më e rëndë që po i bëhet Kosovës, është sjellja në fqinjësi dhe në veçanti sjellja e Beogradit në destabilizimin e Kosovës në tërësi, duke bërë agresione të ndryshme dhe, mbi të gjitha, ato kushtetuese në rajon dhe për Kosovën dhe brenga më e madhe e Kuvendit të Kosovës është në atë që ne ndjejmë si mosreagim adekuat të Brukselit, në veçanti dhe të Bashkësisë Evropiane.

Prania e zotit Paten dhe zotit Hollkeri sot, është një shpresë për Parlamentin e Kosovës, për qytetarët e Kosovës që kjo do të ndryshojë dhe ne, si Parlament, të merremi me sfondimin e ligjeve që krijojnë kushte të barabarta për jetë të qetë të qytetarëve të Kosovës, në një Parlament 14 partishë, në të cilin 7 janë minoritare dhe 7 të mazhurancës.

Zoti Hollkeri, është kënaqësi imja t'ju jap fjalën.

(Duartrokitje)

HARI HOLLKERY:

(Fjala e H. Hollkeri, është transkriptuar nga përkthimi simultan)

(Përkthyesi):

I nderuari kryetar Rugova, kryeministër Rexhepi, kryetar Daci, zonja dhe zotërinj,

Dëshiroj t'ju shpreh falënderimin tim që m'dhat mundësinë t'i drejtohem Kuvendit, edhe pse kjo do t'jetë hera e parë që e bëj këtë dhe t'ju prezentoj dhe njoftoj me një mik të moçëm të Kosovës, që është komisioneri i Bashkimit Evropian për politikë të jashtme, zoti Kris Paten.

Sot shënojmë përvjetorin e dytë të sulmeve terroriste në Nju Jork dhe në Uashington. Vrasja e qytetarëve të pafajshëm nga e mbarë bota, ishte një sulm, të cilin terroristët po e bënin mbi civilizimin, sepse i tërë civilizimi ushqen rrespektin për dinjitetin e qenieve individuale njerëzore dhe janë vlera

këto mbi të cilat edhe Kombet e Bashkuara, Organizata e Kombeve të Bashkuara, është themeluar.

Kur ndodhën sulmet e 11 shtatorit, ajo ditë, ishte paraparë t'ishte ditë ndërkombëtare e paqës. Në cilësinë time, si kryetar i Asamblesë së mileniumit, isha dëshmitar i këtyre ngjarjeve të tmerrshme nga selia e Organiatës së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Para një muaj, Organizata e Kombeve të Bashkuara ka pësuar edhe një nga shpërthim në selinë e saj në Bagdad, një vrasje nihiliste, kur një vetëvrasës me autobombë vrau njerëz të pafajshëm. Unë e di se të gjithë ju më bashkëngjiteni në vendosmërinë tonë për të luftuar terrorizmin, ekstremizmin dhe jotolerancën, kudo që ato ndodhin. Ne të gjithë jemi të shokuar nga lajmet e fundit, nga Stokholmi, kur Ana Lind, ministreshë e punëve të jashtme humbi jetën si rezultat i një sulmi brutal.

Zonja dhe zotërinj,

Unë tashmë jam konsultuar me liderët politik kosovar dhe po ashtu e mirëpres punën të cilën do ta bëjmë bashkërisht gjatë javëve dhe muajve të ardhshëm. Bashkëpunimi ynë efikas është domethënës për vazhdimin e përparimeve në Kosovë. Por, as UNMIK-u, as institucionet e Kosovës nuk mund të përfitojnë në kurriz të tjetrit. Realiteti është i atillë që ne jemi partnerë, partnerë në kuptimin më të thellë dhe në këtë vetëm nëse punojmë bashkërisht do t'ia dalim të gjithave me sukses, sepse ne do të jemi partnerë. Kurse, tani kam kënaqësinë që t'i shpreh mirëseardhje, edhe një herë në Kosovë një miku tjetër të Kosovës, zotit Kris Paten, që është komisioneri i Bashkimit Evropian për politikë të jashtme. Që nga viti 1999 Bashkimi Evropian ka kontribuar dhe ka dhënë më shumë se një miliard euro ndihmë për Kosovën dhe Shtylla e katërtë e UNMIK-ut, Bashkimi Evropian ka marrë rolin udhëheqës për të transformuar ekonominë e Kosovës. Bashkimi Evropian, po ashtu, ka krijuar një mekanizëm të posaçëm që është mekanizmi përcjellës për standardet, i ashtuquajtur i STM që do të përcjellë përmbushjen e standardeve të Kosovës, të cilët do të ndihmojnë në përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës. Ndihma financiare si dhe vetë ky mekanizëm përcjellës, paraqesin vendosmërinë e Bashkimit Evropian për t'i ndihmuar Kosovës që të bëhet anëtar i plotë i familjes së Bashkimit Evropian. Kriteret evropiane për anëtarësim, përfshijnë institucionet demokratike, rend e ligj dhe ekonomi të bazuar në ekonomi të tregut. Prandaj, Qeveria dhe Kuvendi, gjatë miratimit të 27 ligjeve, mund të them se ka qenë në arritur e madhe për të krijuar një ambient të mirëfilltë. Qeveria, pothuaj, ka kompetenca në sfera të ndryshme të jetës së përditshme në Kosovë. Sa i përket fushës së drejtësisë ose zbatimit të ligjit, policët e SHPK, punojnë bashkërisht me ata të UNMIK-ut. Po ashtu janë më shumë se 100 gjyqtarë e prokurorë që punojnë në sistemin e drejtësisë,

që do të thotë se autoriteti përfundimtar për çështje të sigurisë dhe drejtësisë më janë besuar mua, por shumë prej aspekteve administrative të drejtësisë tashmë janë bartur tek institucionet kosovare. Pra, marrja e pronësisë nga institucionet kosovare dhe popullata, mbi këto aspekte, janë me rëndësi në përpjekjet për të përmirësuar gjendjen e sigurisë. Sa i përket ekonomisë, tashmë ka filluar procesi i privatizimit me më shumë se 20 ndërmarrje në pronësi shoqërore, të cilat janë tenderuar.

Një gjë që na ka munduar për një kohë të gjatë është dialogu me Beogradin dhe besoj se tani momenti është i përshtatshëm për të shkuar përpara. Qeveria është duke përgatitur programin e saj për bisedimet me Beogradin që do të fillojnë së shpejti.

Por, një fushë, ku përparimi dhe sukseset janë ende të pamjaftueshme, është fusha e kthimit të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë. Para disa muajve, liderët kosovar kanë treguar një guxim dhe trimëri të madhe duke publikuar një letër të hapur me anë të cilës ftonin pjesëtarët e komuniteteve pakicë të kthehen nëpër shtëpitë e tyre.

Unë e di se miku ynë, Kris Paten, do të pajtohet se shumetniciteti nuk ka ndonjë pengesë dhe nuk duhet të ketë pengesë për krijimin e shoqërisë së mirëfilltë çfarë e synojmë. Prandaj, përkrahja do të jetë e vazhdueshme nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bashkësia ndërkombëtare, Bashkimi Evropian që kanë ndihmuar në të arriturat e shumta dhe në shumë sfera.

Por, në mënyrë që Kosova të vazhdojë rrugën e saj drejt Evropës, duhet të bëhet edhe më tej dhe duhet të vazhdohet me vendosmërinë që është shprehur në letrën e hapur. Pra, duhet mënjanuar brutalitetin, i cili pengon në rrugën drejt Evropës.

Edhe një herë dua t'ju shpreh gatishmërinë time për t'bashkëpunuar me juve, partnerët e mij në të gjitha problemet me të cilat do të ballafaqohet Kosova.

Kurse, tani kam kënaqësinë e posaçme të ftoj zotin Kris Paten. Ju lutem urdhëroni.

(Duatrokitje)

KRIS PATEN:

(Fjala e K. Paten është transkriptuar nga përkthimi simultan)

(Përkthyesi):

Zotni kryetar, zotni kryetar i Kuvendit, zotni Hollkeri, zotja e zotni,

Si tha edhe Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, tash kanë kaluar dy vjet prej ditës së ndodhive të tmerrshme në Nju Jork dhe Uashington. Dhe ndoshta është një mënyrë e zymt e përkujtimit të kësaj dite, që sot ndodhi edhe vdekja e zonjës Ana Lind, si tha zoti Hollkeri, e cila është vlarë në Stokholm. Për të gjithë demokratët, është një ngjarje tepër e zymt kjo. Për të gjithë ata që besojnë se politika është një avanturë e ndershme, sigurisht se ka qenë një e tillë për zonjën Ana Lind, e cila ka qenë e guximshme, e përkushtuar, sharmante, grua, nënë si dhe kryeministreshë shumefikase për vendin e saj. Pra, për të gjithë neve që e njihnim dhe për të gjithë juve që jeni demokratë, është një moment i zymt, që na përkujton se dhuna me të vërtetë përzihet në politikë. Mirëpo, saherë që dhuna përzihet në politikë, ajo lë mbrapa mizerie si dhe varfëri.

Përkundër këtyre hijeve, jam shumë i kënaqur që jam kthyer këtu në Kosovë. Kur kam ardhë këtu herën e parë, dhe tash janë shifrat dyfishore prej se kam ardhur këtu herën e parë në vitin 1999. Kur kam ardhur këtu herën e parë as që kam ëndërruar se një ditë do t'i drejtohesha Kuvendit, udhëheqësve të zgjedhur në mënyrë demokratike këtu në Prishtinë. Ndoshta duhet të vjen një vizitor i cili ua dëshiron të mirën, i cili do të ishte në gjendje të shohë përparimin që e keni arritur ju në partneritet me bashkësinë ndërkombëtare.

Dëshiroj t'i ndajë mendimet e mia përsa i përket partneritetit tuaj me Bashkësinë Evropiane, e cila temë na intereson të gjithëve. Sidoqoftë, është një pikë të cilës do t'i kthehem me një gjuhë shumë më të sinqert e më të hapur. Mirëpo, tash kur jam në fund të karrierës politike, pa ndonjë ambicie të madhe politike, kam të drejtën t'i them gjërat ashtu si i shoh.

Çështja e statusit përfundimtar të Kosovës ende nuk është për diskutim, mirëpo atë që e dijmë të gjithë plotësisht qartazi është se ardhmëria juaj është në Evropë. Ky ka qenë përkushtimi i krejt Bashkësisë Evropiane në takimin e saj në Selanik, në qershor dhe më vjen mirë që mundem edhe një herë ta konfirmoj atë premtim sot. Vitin e ardhshëm, vendet e Evropës juglindore do

t'i bashkëngjiten familjes sonë evropiane. Para dhjetë vjetësh dukej si një ëndërr në qiell, e porealizueshme, mirëpo tash po shohim zhvillimin e vendeve demokratike, me ndihmën tonë, të cilat po hyjnë në Bashkësinë Evropiane. Ata ia kanë dalë. Këtë mundeni edhe ju.

Roli i këtij Kuvendi është shumëqënësor që të kuptohet kjo e ardhme evropiane për Kosovën. Ju jeni përfaqësuesit e zgjedhur në mënyrë demokratike të popullit, dhe është përgjegjësi juaja që Kosovën ta çoni në rrugën e stabilizimit, demokratizimit dhe modernizimit. Ju jeni këtu për të punuar për mirëqenien e gjithë njerëzve në Kosovë, pa marrë parasysh etninë apo bindjet e tyre politike apo shoqërore. Ky Kuvend është forumi i demokracisë kosovare, ku ju diskutoni dhe argumentoni në mënyrë demokratike dhe civilizuese. Nuk do të befasoheshim nëse nganjëherë bëni zhurmë. Zhurma në kuvend, si e dijmë të gjithë, është zhurmë e lirisë. Nuk po i përdori këto fjalë tepër lehtë. Unë kam qenë deputet i Haus of komenes në Britani, po ashtu një i tillë në Evropë dhe e di se sa është kyç funksionimi i një parlamenti për lulëzimin e demokracisë. Si deputetë të këtij Kuvendi keni një rol të veçantë dhe shpresoj kurrë nuk do ta harroni këtë.

Ka kaluar një vit prejse kam ardhur herën e fundit në Kosovë, mirëpo i kam përcjell ngjarjet me interes të madh. Siç kam thënë më herët, ka patur shumë zhvillime pozitive për të cilat mund të jeni krenar. Mirëpo ka patur edhe tragjedi në vazhdimësi, sikur janë vrasjet tash rishtazi të fëmijëve të pafajshëm. Këto ndodhi të tmerrshme nuk janë tragjedi vetëm për viktimat, por për tërë Kosovën. Ato janë njollë në reputacionin e Kosovës. Dhuna, dëshmitare e së cilës është Kosova, nuk mund të garantojë bashkëjetesën paqësore këtu dhe do të ketë pasoja për tërë rajonin. Pra, ju duhet të bëni krejt çka është e mundur që të ndalni këto sulme dhe kundërsulme. E di se shumë politikanë kosovar kanë folë kundër këtyre sulmeve dhe edhe një herë ju përgëzoj juve që keni bërë këtë si përfaqësues të krejt popullit të Kosovës. Të gjithë ju keni një përgjegjësi të veçantë që pa ekuivoqe të denoni njerëzit e këqinj, të cilët kanë vra bashkëkombësit e tyre, apo bashkështetasit e tyre.

Po ashtu, ju nxis që t'i dyfishoni përpjekjet, në mënyrë që fjalët tuaja të përcillen në vepra, që bëjnë ndryshime. Dhe, duke bërë gjithkëtë, duhet të punoni së bashku me partnerin tuaj të çmuar – Kombet e Bashkuara. Ju dhe UNMIK-u duhet të jeni ambicioz dhe të synoni më shumë sesa vetëm ta ndalni ciklin e dhunës.

Po ju kërkoj edhe një herë që të bëni përpjekje të krijoni një shoqëri ku secili është i barabart, jo vetëm para ligjit por edhe në praktikë. Vetëm atëherë, ata që kanë lënë këtë vend për shkak të frikës dhe dëshprimit, do të kenë besim në porosinë shuminkurajuese, të cilën ju ia keni dërguar personave që kanë lënë

Kosovën dhe jetojnë jashtë këtij vendi dhe ata mund të kenë besim se do të mund të kthehen këtu dhe të jetojnë në paqë.

E dij se deri tash, ky Kuvend, ka bërë shumë. Po ashtu edhe Qeveria, partneri juaj UNMIK-u, por realiteti tregon se duhet bërë shumë më shumë, jo vetëm nga ju që jeni në qendër këtu në Prishtinë, por kjo vlenë për çdo komunë anëmbanë Kosovës. Nuk ka ndonjë detyrë më të rëndësishme për Kosovën, e cila dëshiron të demonstrojë se është e përkushtuar për një të ardhme paqësore demokratike.

Unë e di, dhe i kthehem asaj që thash në fillim, e di se të gjithë jeni të shqetësuar për statusin përfundimtar të Kosovës. Kjo nuk është temë që do të trajtohet sot, mirëpo natyrisht nuk është ndonjë temë që mund të shtyhet pafundësisht. Ajo që është me rëndësi, është që secili, pa marrë parasysh a është në Beograd apo këtu në Prishtinë, duhet të mos ndërmarrë më veprime të cilat ngrisin tensione. Këtë duhet ta bëj plotësisht të qartë edhe nesër në Beograd. Deklaratat parlamentare kundër pavarësisë janë, nëse e themi shumë but, të padobishme. Të tilla do të ishin edhe deklaratat e pavarësisë nëse bëhen këtu. Asnjëra nuk do të kishin ndonjë ndikim më të vogël në vendimin përfundimtar.

Ajo që do ta diskutojmë sot është fillimi i një dialogu të ri e konstruktiv me Beogradin. Ky do të duhej të ishte prioritet, për të gjitha institucionet e Kosovës dhe për UNMIK-un, të niset dialogu me Beogradin për çështje të cilat kanë të bëjnë me jetën e përditshme të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Nisja e dialogut do të çonte një porosi shumëpozitive për komunitetin tuaj, do të tregojë se ju jeni udhëheqës që mund të merrni përgjegjësinë mbi vete në një mënyrë shumëkonstruktive dhe do të tregonte qartazi se kur themi që Kosova është në rrugën drejt Evropës, kjo nuk është për shkak se vetëm gjeografikisht e politikisht jeni pjesë e Kontinentit të Vjetër, por se jeni mjaft të pjekur për të folë me ata me të cilët nuk pajtoheni në shumë gjëra. Nuk jeni vetëm në këtë dialog. UNMIK-u do të jetë në anën tuaj t'ju përkrahë. Nisma, sikur janë trajnimi i nëpunësve civil, që do të kryhen nën ombrellën e OSBE, në bashkëpunim me Institutin e Paqës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, do t'i ndihmojnë administratës tuaj për këtë dhe për shumë sfida tjera.

Mirëpo, dua të them diçka shumë fuqimisht. Bashkësia ndërkombëtare, miqt tuaj në Amerikë, miqt tuaj në Evropë, të cilët janë plotësisht me njëmendje lidhur me këto çështje – nuk mund t'ju japin vullnetin politik që t'i çoni sendet përpara, që duhet të vijnë prej jush. Ka një dallim në mes asaj të jesh në gjendje të ndihmsh diçka dhe të ulesh vetë në tavolinë. Ne do t'ju përkrahim në mënyrë aktive në dialogun tuaj sepse jemi shumë të përkushtuar për rajonin e Ballkanit përëndimor. Këtë e kemi dëshmuar shumë me ndihmën

financiare të bollshme, si dhe me përfshirjen tonë politike. Jo vetëm që dëshirojmë të jemë pjesëtarë të dialogut, sepse dojmë t'ju ndihmojmë, mirëpo, po ashtu për shkak se si Bashkësi Evropiane kemi një përvojë të madhe për krijimin e konsensusit në mes palëve të cilat kanë dallime drastike, e po ashtu, sepse kemi interes të madh që të sigurohemi se ky rajon do të shkojë kah Bashkësia Evropiane, në një mënyrë paqësore e demokratike.

Shum është bërë në Kosovë në katër vitet e fundit, diçka që thash edhe më herët. Shum më shumë mund të bëhet dhe duhet të bëhet për ta lehtësuar jetën e kosovarëve dhe nuk ka ndonjë rrugë të shkurtër, sepse duhet të ketë një sistem ligjor administrativ të tillë që Kosova të bëhet një vend i besueshëm i cili tërheq investime si nga jashtë ashtu edhe nga brenda. Donatorët këtu janë të gatshëm t'ju ndihmojnë juve dhe partnerëve nga UNMIK-u që ta arrini këtë qëllim. Ne propozojmë që ju, standardet tuaja, t'i ofroni me tonat. Ne nuk pretendojmë se ligjet tona janë të lehta të implementohen, mirëpo kur theksojmë nevojën e harmonizimit të ligjeve me Bashkësinë Evropiane, në këtë e bëjmë, sepse besojmë se kjo duhet t'ju japë një përparësi e që do t'ju japë përfitime në zhvillimin tuaj ekonomik, e jo vetëm se është kërkesë për anëtarësi në Bashkësinë Evropiane.

Implementimi i reformave të ngjashme me ato në rajon do t'ju çojë më afër Evropës. Ju do të mund të përfitoni nga përparësitë e bashkëpunimit rajonal, i cili tashmë ka filluar në Evropën juglindore. Një shembull i qartë është Marrëveshja e tregtisë së lirë që UNMIK-u tashmë e ka nënshkruar me Shqipërinë, nën ombrellën e Paktit të Stabilitetit. Pjesëmarrja në këtë rrjet marrëveshjesh do t'ju përmirësojë qasjen në tregje dhe do ta bëjë Kosovën shumë më tërheqëse për investitorë. Për këtë qëllim, Bashkësia Evropiane, këtë vit, së bashku me ju, me institucionet e përkohshme dhe UNMIK-un, një mekanizëm përcjellës, që e përmendi edhe zoti Hollkeri, është që t'ju udhëzojë dhe afrojë në Bashkësinë Evropiane, nëpërmjet një procesi i cili, të jam i sigurt, do të jetë shumë i vështirë.

Më vjen shumë mirë që kam dëgjuar për angazhimet e mëdha personale të kryeministrit që kryeministri dhe ministrat e kanë bërë lidhur me këtë. Ju keni parë rëndësinë, si afatgjate, ashtu edhe afatshkurtër të këtij procesi, që në të njëjtën kohë do t'ju afrojë edhe një vlerësim se ku qëndron një Kosovë dhe një lloj harte se kah duhet të shkon.

Më lejoni të theksoj se mekanizmi përcjellës, po ashtu, do t'ju ndihmojë juve dhe UNMIK-un në zbatimin e standardeve të cilat do të masin përparimin tuaj në rrugën e normalizimit të jetës. Duhet të jeni të gatshëm, sepse ky proces do të bëhet gjithnjë e më i vështirë sa të vazhdojë. Thash edhe një herë se nuk ka një rrugë më të shkurtër që çon në reforma. Reformat e njëjta shoqërore,

demokratike e politike duhet bërë gjithkund prej Vilniusit në Tiranë, prej Lubjane në Sofi. Por, e gjithë kjo punë e vështirë do të shpaguhet, sikur tregon edhe zgjerimi që bëhet tash i Bashksësi Evropiane.

Të insistoj edhe një herë se, jo vetëm ne në Evropë, por edhe partnerët tanë nga Amerika, institucionet monetare e ndërkombëtare, si dhe gjithë donatorët tjerë ju mbështesin dhe mbështesin Bashkësinë Evropiane në përkrahjen e Kosovës, në rrugën drejt familjes tonë.

Në fund të fundit, reformat janë përgjegjësi juaja. Unë dëgjova se jeni në rrugë të drejtë. Më lejoni, për shembull të përmend se sa më ka lën përshtypje kur dëgjova për ligjin omnibus të antidiskriminimit, që e përpilon Qeveria, duke marrë parasysh standardet evropiane. Mund vetëm t'ju inkurajoj që të vazhdoni në këtë rrugë dhe t'ju siguroj se Bashkësia Evropiane ka qenë dhe do të mbetet e gatshme që t'ju ndihmojë në secilin hap të kësaj rruge. Të përmend, lidhur me këtë, se Agjencioni Evropian për Rindërtim, në mënyrë aktive, i ndihmon Zyrës së kryeministrit, si dhe ministrive të ndryshme me këshilla të ekspertëve, si dhe ka nisë të përkrahë edhe këtë Kuvend me ndihmë për krijimin e një shërbimi administrativ dhe teknik që është qenësor nëse dëshironi të mirreni me një punë gjithnjë e më të madhe legjislative.

Natyrisht se gjithë kjo bëhet në koordinim me shtetet anëtare të Evropës, si dhe partnerët tjerë në Kosovë, në mënyrë që t'ju ndihmojnë që të merreni me këtë detyrë sfiduese.

Besoj se ne, në Komisionin evropian kemi treguar përkushtimin tonë të plotë për këtë rajon me financimin e bollshëm ku, nëse përfshihet edhe ndihma humanitare, që përmendi edhe PSSP, gati 1.4 miliard të të hollave të taksëpaguesve dhe shumica, ndoshta jo krejt, të menaxhuara nga Agjencioni Evropian... I keni të njohura të gjitha këto të arritura, mirëpo asnjëherë nuk lodhem duke i përsëritur si dëshmi e realitetit praktik të gatishmërisë së Bashkësisë Evropiane për Kosovën. Janë ndërtuar shtëpi për njëqind mijë njerëz, përmirësimi i sistemit të ujit për gjysmë milioni, riparime të 400 km rrugë, si dhe rindërtimi i disa urave, kryerja e projekteve të zhvillimit për komuna, rehabilitimi i minierave të thëngjillit të Kosovës si dhe termocentraleve të Kosovës, ku tashmë kemi kryer riparimin që është bërë nga zjarri i vjetshëm, po ashtu në ndihmë ligjore dhe përmbi 5200 huave që iu janë dhënë bujqve dhe bizneseve të vogla dhe ka edhe më shumë se kaq.

Më lejoni ta them edhe një fjalë, të fundit lidhur me atë se ku besoj jeni duke shkuar dhe çka kërkohet. Kur më herët takova ministrat tuaj, sikur iu tregova edhe atyre, isha i ulur afër mikut dhe kolegut tim, zoti Nikolla Slemsdorf, djali i një udhëheqësi dhe burrështeti gjerman, që sigurisht e njihni. Ia

përkujtova kryeministrit dhe kolegëve të tij se çka është në thelb Bashkësia Evropiane. Bashkësia Evropiane është shembulli më i mirë i institucionalizuar i pajtimit historik. Vjehri im është vlarë pak para përfundimit të luftës së kaluar dhe në kolegjin e tij në Universitetin e Kembrixhit ka një përkujtimore për të gjithë studentët e atij kolegj, të cilët kanë vdekur në dy luftërat botërore. Ka një listë të gjatë të emrave. Natyrisht, shumica prej këtyre janë emra të britanezëve, mirëpo ka në mes tyre edhe emra të gjermanëve, studentë britanez e gjerman që kanë studiuar së bashku, e dikur kanë filluar të gjuajnë në njëri-tjetrin. Pse? Për shkak të shprehjeve më të dhunshme dhe më të ashpra të nacionalizmit. Bashkësia Evropiane është krijuar që ta parandalojë këtë dhe të mos përsëritet më. Bashkësia Evropiane, është bashkësi e pakicave, të cilat janë munduar ta gjejnë një rrugë nëpërmjet së cilës tërheqja dhe zemërgjerësia do të mund të krijonin paqe për qytetarët. Pra, mos u befasoni kur këtu në Kosovë, apo në Serbi, apo diku tjetër në rajon, ne flasim sikur flasim për pajtimin, edhe flasim ashtu sikur flasim deri tash për tmerret e dhunës etnike, urrejtjes etnike dhe konfliktit etnik.

Ju keni një rast të mirëfilltë këtu në Kosovë, ku bashkësia ndërkombëtare don që ju gjithësesi të keni sukses. Ju është dhënë një rast i mirëfillt që t'i tregoni botës se këtu keni qenë në gjendje t'i varrosni armiqtë e të kaluarës dhe keni qenë në gjendje të krijoni një ardhmëri e cila është e drejtë për të gjithë, pa marrë parasysh fenë apo etninë, një të ardhme, e cila i vlerëson njëjtë të gjithë, pa marrë parasysh besimet e tyre fetare apo origjinën e tyre.

Unë shpresoj shumë se ju do të mund të ballafaqoni me këtë sfidë. Është një sfidë e vështirë dhe është një rrugë e vështirë. Mirëpo, një arsye që shumë prej nesh jemi në politikë, që shumëshpesh kritikohet, është se do të duhej të ishte një aventurë e ndershme, sikur e tregoi zonja Ana Linds në jetën e saj të shkurtër politike.

Unë mund t'ju siguroj se Kosova mund të ballafaqohet me këto sfida, në mënyrë që të jenë të ndershme dhe që don të thotë se djemt dhe biat tuaja kanë një të ardhme shumë më të mirë, një shoqëri shumë më të mirë, ku do të jetojnë sesa që keni patur ju. Zotni kryetar, ju falemnderit shumë.

(Duartrokitje)

KRYESUESI NEXHAT DACI:

I rrespektuari zoti Paten, zoti Hollkery, është kënaqësi imja t'ju falënderoj sinqerisht në emër të këtij Parlamenti dhe të popullit të Kosovës për qartësimin e rrugës dhe të dhënies së një vizioni të qartë për paqë, për demokraci dhe se Kosova do të jetë pjesë e Evropës në të gjitha kuptimet, duke krijuar një ligjshmëri që është kompatible me vendet tuaja dhe ne do ta mbajmë mend dhe do të shënohet si një datë e shënuar në Parlamentin e Kosovës që ju kishim mysafirë. Edhe njëherë ju falënderoj të gjithëve.

Tani do të kemi 10-15 minuta pauzë dhe do të vazhdojmë pastaj me seancën.

(Vijon pauza)

(Pas pauzës, seanca vazhdoi punën)

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Të nderuar deputetë, po vazhdojmë punën.

Pika vijuese e rendit të ditës është: Miratimi i Procesverbalit nga seanca e kaluar.

Mendoj se do të vazhdojmë me praktikën e deritashme, ata që kanë ndonjë sygjërim apo vërejtje, mund t'i bëjnë me shkrim.

Kalojmë menjëherë në: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prokurim publik të Kosovës 2003/13.

Është bërë radhitja e amendamenteve, të paraqitur në tekstin e Projektligjit për prokurim publik në Kosovë, të propozuara nga Komisioni për shërbime publike; Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese; Komisioni për buxhet dhe deputeti Fatmir Rexhepi.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për prokurim publik në Kosovë ka bazueshmërinë në Kornizën kushtetuese.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se Projektligji për prokurim publik në Kosovë, nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për buxhet, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për prokurim publik në Kosovë, nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për financa dhe ekonomi, i jep përkrahje parimore Projektligjit me amendamentet e propozuara.

Amendamentet e propozuara, në mënyrë specifike, reflektojnë qëndrimet e komisioneve parlamentare dhe të deputetit Fatmir Rexhepi.

Prandaj, fillojmë menjëherë me amendamente.

Amendamenti 1, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 4, Deputeti Fatmir Rexhepi, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit.

Komisionet tjera nuk e kanë shqyrtuar.

Kush është për këtë propozim të amendamentit? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Një votë kundër.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, Deputeti Fatmir Rexhepi, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit. Komisionet tjera nuk kanë mendim.

Kush është për këtë propozim?

Po, urdhëroni, në emër të Komisionit.

BUJAR DUGOLLI:

Në emër të Komisionit funksional. Komisioni për shërbime publike i ka shqyrtuar këto me kohë, më datën 26. 06 dhe ka përfunduar shqyrtimin e këtij ligji dhe mendon se amendamentet e deputetit Fatmir Rexhepi, janë amendamente që kanë ardhur në procedurë jo të rregullt dhe jo me kohë, prandaj Komisioni për shërbime publike nuk i ka përkrahë këto amendamente dhe qëndron në ato që i kanë shqyrtuar komisionet, ai i kornizës kushtetuese, Komisioni i buxhetit dhe Komisioni funksional. Do të thotë Komisioni për shërbime publike nuk ka përkrahë amendamentet e deputetit Fatmir Rexhepi, që të mos përsëritet që s'ka qëndrim, sepse dje i kemi diskutue. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Kush është për propozimin e deputetit Fatmir Rexhepi dhe të Komisionit për buxhet? Ju falemnderit shumë.

Kush është kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5, Deputeti Fatmir Rexhepi, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit dhe sqarimet që dha Dugolli.

Kush është për këtë amendament? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? 3 vota kundër.

A ka abstenime? 8 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6, Komisioni i buxhetit, me sqarimet.

Kush është për? Ju falemnderit.

Kush është kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? 8 abstenime.

Amendamenti kalon.

Amendamenti 7, Komisioni i buxhetit, me sqarimet që dha Dugolli.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? 8 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 8, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon ndokush? 2 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 9, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 10, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 11, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 12, Komisioni funksional, i përkrahur nga komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 13, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? 1 abstenim.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 14, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 15, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? 1 abstenim.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 16, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 17, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askuksh.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 18, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 19, deputeti Fatmir Rexhepi, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit, me sqarimet e Dugllit.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 1 votë kundër.

A abstenon ndokush? 12 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 20, Komisioni për çështje gjyqësore, i përkrahur nga komisionet tjera.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? 1 abstenim.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 21, deputeti Fatmir Rexhepi, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit, me sqarimet e Dugollit.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 1 kundër.

A abstenon ndokush? 9 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 22, deputeti Fatmir Rexhepi, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit, me sqarimet nga Komisioni funksional.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? 8 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 23, Komisioni për çështje gjyqësore, i përkrahur nga komisionet tjera.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 24, deputeti Fatmir Rexhepi, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit, me sqarimet e Dugollit.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 1 kundër.

A abstenon ndokush? 11 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 25, deputeti Fatmir Rexhepi, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit, me sqarimet e dhëna prej komisioneve.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 2 kundër.

A ka abstenime? 11 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 26, deputeti Fatmir Rexhepi, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit, me sqarimet e mëparshme të zotit Dugolli.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 2 kundër.

A abstenon ndokush? 9 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 27, deputeti Fatmir Rexhepi, i përkrahur nga Komisioni i buxhetit, me sqarime nga komisioni i mëparshëm.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? 1 kundër.

A abstenon ndokush? 11 abstenime.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 28, Komisioni për çështje gjyqësore, i përkrahur nga komisionet tjera.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 29, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Pakica është për, 3-4.

Nuk kalon amendamenti. Mbetet siç është në ligj.

Amendamenti 30, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush? 1 abstenim.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 31, Komisioni për çështje gjyqësore, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër. Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 32, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese, i përkrahur nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për? Ju falemnderit.

A ka votë kundër. Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Amendamenti 33, Komisioni për çështje gjyqësore, pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për?

Urdhëroni...

BUJAR DUGOLLI:

Mendoj se kjo praktikë, siç janë duke u votuar këto amendamente, do të duhej ta shqyrtojmë edhe një herë këtë Projektligj, sepse janë gabimet aty dhe Sekretaria nuk e di... Është shumë qartë... Disa nene në amendamente, janë përkrahur nga Komisioni funksional dhe këtu po thirrëni se nuk janë përkrahur.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Kështu është e shkruar te unë, zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Këta i kanë ndërrue, e ka ndërrue Sekretaria, se nuk është e vërtetë që 33-shi, 29-shi janë të përkrahur, por kjo është një ndërrim... Ne jemi duke bërë gabime esenciale në ligj, që ky ligj do të na kthehet prapë. Ju lutem, më ngadalë të punojmë, e në rast se kemi mosmarrëveshje, t'i zgjidhim ato. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Saherë që ke kërkuar fjalën, t'u ka dhënë. Do të thotë tash u sqarua.

Do të t hotë – Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion kornizë kushtetuese, me përkrahje të Komisionit funksional, apo jo Dugolli, dhe komisionet kryesore, apo pa to.

Kush është për, domethënë me përkrahje? Ju falemnderit.

A ka votë kundër? Nuk ka kundër.

A abstenon ndokush? Askush.

Kalon amendamenti.

Do të thotë, aty ku ka gabime, ju lutem kryetarëve të komisioneve le të reagojnë se ka gabime të tilla.

Amendamenti 34, Komisioni për çështje gjyqësore, pa përkrahje, apo jo Dugolli...

Urdhëroni...

SABIT RRUSTEMI:

I nderuar kryetar, deputetë, kryesi e punës,

Kujtoj se ne jemi marrë vesh edhe më herët për do çështje që kanë të bëjnë me lekturën, edhe për ato që s'janë në amendamente, të mos i amendamentojmë fare.

Te neni 34, e kemi në rast që unë, vërtetë, kërkoj shpjegime. Thotë, të zëvendësojë fjalën "individ" me "një anëtar individual"! Çfarë dallimi ka dhe çfarë kuptimi ka kjo. Ata që e kanë propozuar, bash kërkoj që t'më dhënë sqarime. "anëtar individual"! Vërtetë, nuk ka kuptim. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Edhe një herë kërkoj të sqarohet: A është përkrahja e komisioneve tjera?

(Prej vendit: Jo, jo.)

JAKUP KRASNIQI:

Të nderuar deputetë,

Fillimisht dua t'ju them, më vjen keq që nuk kam pas njoftim zyrtar që sot, në këtë seancë, do të shqyrtohet ligji për prokurimin publik. Unë, tepër vonë,

kam marrë disa amendmente nga deputeti Rexhepi. Kemi diskutuar rreth tyre dhe jam i obligueshëm ta sqaroj këtë Kuvend se është duke u krijuar, në disa aspekte, një presedan që nuk do t'i shërbejë as Parlamentit e as ligjit dhe as të aprovimit të ligjit.

Dua t'u them se, amandmentet, disa amandmente kryesore që afrohen nga deputeti Rexhepi, bien ndesh me Rregulloren 2001/19...

(Ndërhyrje, nga vendi, nuk dëgjohej qartë)

Ju lutem, unë po e shpjgoj, e pastaj e bëjmë si të doni ju, dhe veproni. Unë jam i obligueshëm t'u tërheki vërejtjen. Dy, bie ndesh me ligjin, ose rregulloren e shërbimit civil, dhe bie ndesh me standardet, të cilat janë të njohura për ligjet e prokurimit publik. Bëhen tri gabime dhe unë dyshoj që ligji, nëse aprovohen këto tri segmente, ligji mund të mosaprovohet dhe ligji mund të rikthehet në rishqyrtim.

Është në interesin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës, që është duke u rrënuar nga prokurime të paligjshme, që ky ligj të aprovohet. Dhe disa ndryshime që unë i ceka, këto tri sferat, mund ta bëjnë që ligji të mosaprovohet dhe të vazhdohet, në sferën e prokurimit publik, të veprohet në mënyrë të paligjshme.

Jo. Aty ku preken tri amendmentet, po ju them sinqerisht, e damtojnë ligjin e prokurimit publik dhe në një formë ose tjetër, ndryshimet nuk janë profesionale, janë politike dhe janë thirrje për korrupsion në institucionet e Kosovës, në të gjitha nivelet.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, ministër. Zoti Ivanoviq, si anëtar i Kryesisë.

OLIVER IVANOVIĆ:

Uz svo poštovanje gospodina ministra, ja mislim da, po Poslovniku o radu Skupštine, nemate pravo na intervenciju tog tipa, kakvu ste napravili sada i uvažavam to što kaže da verovatno saradnja između poslaničkih grupa, između komisija, nadležnih komisija i ministarstva, nadležnog ministarstva, nije bila dobra i svakako podržavam to da vi pokrenete svoju inicijativu da se zakon, kao takav, ne usvoji, odnono ne potpiše. Ali, u ovoj fazi, mi

razmatramo samo amandmane i moj osvrt je vezan na zadnjeg diskutanta, a to je da, ova po meni... Ja sam pratio ove amandmane do sada, ovaj član amandmana 34., u suštini ima u novinu, nije samo jezička promena, nego on menja reč «lice» rečima «jedno lice ili spoljni ekspert». To je bitno različito. Zbog toga predlažem da se ovaj amandman, kao takav, usvoji. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Urdhëroni. E ka fjalën zoti Hamiti.

SABRI HAMITI:

Unë, me një ndërgjegje përfaqësuesi dhe ndërgjegje deputeti, jam i detyruar t'i them dy-tri fjalë, pasi dëgjova ministrin Krasniqi.

Meqë njerëzit, unë po e shoh, fort shpesh, kur i lexojnë amendamentet nuk mbajnë në anën e majt edhe ligjin për të parë çfarë janë dhe për të mos i manipuluar ata që s'i lexojnë mirë.

Unë po them, këto propozime, në të vërtetë konsistojnë në ndërrimet, saktësisht, për të mos pasë keqpërdorime. Dhe ky është çelësi, ky është thelbi i atyre ndërrimeve. Mos të shkojnë njerëzit me përshtypjen që bëhen... Përkundrazi, më lehtë është me u korruptua një njeri se një qeveri! Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, edhe profesoresha, që e ka formuluar, dëshiron ta marrë fjalën. Urdhëroni...

NERXHIVANE DAUTI:

Në emër të Komisionit për legjislacion, i kam përpiluar amendamentet e propozuara, të cilat u aprovuan deri më tash. Fjala është për nenin 98.2, ku kam propozuar që të zëvendësohet... Po e lexoj nenin 98.2: "Kryesuesi është i autorizuar që të caktojë një individ për të organizuar dhe menaxhuar punën e komisionit rregullativ në një lëmi të caktuar. Kryesuesi, gjithashtu, është i autorizuar që të ftojë ekspertë nga jashtë për të marrë pjesë në punën e

komisionit rregullativ". Pra, fjala është për zëvendësimin e një individi me ekspert nga jashtë. Ky është përmirësimi që do të duhej të bëhet.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë do t'ju lutësja. Kësaj radhe, ishte rrespekti ndaj ministrit. Ministrat, në fazën e amendamentimit, të mos kërkojnë fjalën. Mos më bini në pozitë, sepse nuk është dëshirë imja, që mos t'ua dhë fjalën. Deri në këtë fazë është e mundshme ndërhyrja, tutje vendosin deputetit dhe marrin përgjegjësinë deputetët dhe Parlamenti.

Prandaj, edhe një herë, amendamenti 33, Komisioni për çështje gjyqësore, pa përkrahje të komisioneve tjera.

Kush është për, i lutem të çojë dorën: 14 vota për.

Nuk kalon amendamenti.

Amendamenti 34, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion, dhe prap pa përkrahje nga Komisioni funksional dhe komisionet kryesore.

Kush është për?

